

VENDIM
Nr.272, datë 6.4.2011

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR VLORE - ORIKUM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës Vlorë - Orikum.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 7 409 (shtatë mijë e katërqind e nëntë) m² tokë arë, me vlerë 1 738 750 (një milion e shtatëqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë, si dhe për kulturat drufrutorë, me vlerë shpronësimi 852 470 (tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind e shtatëdhjetë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 2 591 220 (dy milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e një mijë e dyqind e njëzet) lekësh.
4. Shpenzimet procedurale, në shumën 879 000 (tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 2 591 220 (dy milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e një mijë e dyqind e njëzet) lekësh të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.
6. Shpronësimi të fillojë më 1.4.2011 dhe të përfundojë më 1.7.2011.
7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
8. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
9. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Saktësim dokumentacioni”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të jetë dhënë një rikonfirmim lidhur me titullin e pronësisë dhe të jetë vënë në dispozicion harta treguese e përditësuar, pas saktësimit të pasurisë nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Vlorë.
10. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, të kryejë likuidimin e pronarëve për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja Vlorë”, pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e plotë të pronësisë.
11. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve për të cilët është bërë shënimi “Saktësim dokumentacioni”, në bazë të pikës 9 të këtij vendimi, pasi të jenë kryer të gjitha verifikimet në terren.
12. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Vlorë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e

shpronësuar në favor të shtetit.

13. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Vlorë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në çastin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuar.

14. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, ZQRPP dhe ZRPP-ja Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha